



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 511

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 419, NGA Z. IVI KASO PËR HAPJEN E ZYRËS ZGJEDHORE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" AFËR QV-SË, BASHKIA LUSHNJE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 13 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso

OBJEKTI: Kërkohet marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për hapjen e zyrës zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër QV-së nr. 2967, Bashkia Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Z. Ivi Kaso. Denoncimi është regjistruar me nr. 419 ID, datë 12.5.2023 të regjistrit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se: *“Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka hapur zyrë zgjedhore në një distancë shumë të afërt me vendndodhjen e QV nr. 2967, Shkolla e Mesme e Bashkuar, Kolonjë, Lushnjë.”*

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ filloi hetimi administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ –ja në Bashkinë Lushnjë, nëpërmjet postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me zyrën zgjedhore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë” në Shkollën e Mesme të Bashkuar Kolonjë, Lushnjë.

Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi zyra zgjedhore rezulton të jetë afërsisht 80 metra nga QV nr. 2967, Shkolla e Mesme e Bashkuar, Kolonjë, Lushnjë.

Raporti i monitoruesit është i shoqëruar me foto të zyrës zgjedhore.

Nga analiza ligjore, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raporti i monitorueses vlerësojmë se zyra zgjedhore është vendosur në kundërshtim të nenit 5, pika 1 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, të Kodi Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Lushnjë, për mbylljen e menjëhershme të zyrës afër QV nr. 2967, Shkolla e Mesme e Bashkuar, Kolonjë, Lushnjë.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Lushnjë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Lushnjë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI